



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:027906

Datë: 04.04.2024

Numri i dokumentit: 05543171

P.nr./..

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL gjyqtari i vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrje të bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurave Sh.. M.. për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 par.3 nen par. 3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe E.. M.. për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, te akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme PP/II-nr.291/2021 të datës 12.02.2021, jashtë seancës gjyqësore me datë 04.04.2024 bie këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr./.. e datës e lidhur në mesë të pandehurave njëkohësisht të dëmtuarave Sh.. M., E.. M.. dhe të dëmtuarës M.. (P..) G.. nga P.. rr. E.. Gj.. nr. ...

II. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore ne Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II-nr.291/2021 të datës 12.02.2021.

III. PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurave:

SH.. M.., e lindur me datën në P., ku edhe banon rr. “P.. S..”, e bija e S... dhe nënës M.. e vajzërisë G., poseduese e nr. tel., poseduese e nr. tel..., e identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr....., e nacionalitetit Shqiptar, shtetase e R. Kosovës.

- për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 par.3 nen par. 3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së

E.. M.., e lindur me datën në fsh. Q.. K. K., tani me banim në P., rr. “E.. Xh..” nr. ..., e bija e T.. dhe nënës G.. e vajzërisë B., poseduese e nr. tel....., e identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr....., e nacionalitetit Shqiptar, shtetase e R. Kosovës.

- për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamentit të Përgjithshme me datën 12.02.2021 ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.291/21 ndaj të pandehurave Sh.. M.. për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 par.3 nen par. 3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe E.. M.. për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së

Me datën 28.03.2024 është arrit marrëveshja në zyrën e ndërmjetësimit në mesë të pandehurave njëkohësisht të dëmtuarave Sh.. M., E.. M.. dhe të dëmtuarës M.. (P..) G.. nga P.. rr. E.. Gj.. nr. ..., e cila marrëveshje i është dozuar gjykatës ne kopje të mjaftueshme.

Nga te cekurat me lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke e pranuar marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr../.. e datës e lidhur në mesë të pandehurave njëkohësisht të dëmtuarave Sh.. M., E.. M.. dhe të dëmtuarës M.. (P..) G.. nga P.. rr. E.. Gj.. nr. ...

Me dispozitën ligjore të nenin 229 par. 5 të KPRK-së është përcaktuar se: nëse aktakuza është dorëzuar, gjyqtari i vetëm gjykues, nëse e pranon formalisht marrëveshjen, merr vendim për të hedhur aktakuzën dhe e ndërpre në procedurën penale.

Andaj nga të cekurat më lartë e në kuptim 229 par.5 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM ,
DIVIZIONI PENAL
2021:027906, 04.04.2024**

Bashkëpunëtorja Profesionale

Gj y q t a r i

Edona Berisha Kastrati

Musë Povataj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate, në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit.